21. Fondi nr. 4, Drejtoria e I, Viti 1985, Dosja nr.119 “Listat dhe relacionet përkatse për të arratisurit gjatë viteve 1944-1950 ardhur nga degët e rretheve Ersekë, Tepelenë, Pogradec, Skrapar e Pukë për Degën e I-rë të Drejtorisë së I-rë”, me 145 (njëqind e dyzet e pesë)fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitin 1985.
22. Fondi nr. 4, Drejtoria e I, Viti 1976, Dosja nr.44 “Informacione dërguar K.Q.P.P.Sh-së mbi arratisjen në Jugosllavi të familjes së Kimet Kojtorit”, me 15(pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitin 1976.
23. Indeksi i të arratisurve, nr. 3, grupi II-13, me 151 (njëqind e pesëdhjetë e një) fletë dhe 41 fletë me listë emërore e të arratisurve, fëmijë të tërhequr në arrati, atyre të lindur jashtë shtetit, si dhe grave me kombësi shqiptare e të huajtë martuara me të arratisurit jashtë shtetit. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Indeksi i përket Fondit ish Dega Punëve të Brendshme Pogradec.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 1, datë 15.01.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me Vendimin nr. 3, datë 05.02.2021, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

I. Deklasifikimin e plotë të dosjeve:

15. Dosje kërkimi dhe dosje formulare nr 301, në ngarkim të E. L., përkatësisht me 119 (njëqind e nëntëmbëdhjetë) fletë dhe 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë + zarf me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1944-1958. Dosja i përket Fondit ish Të Arratisur.
16. Dosje formulare nr. 3559, në ngarkim të G. H., me 87 (tetëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1979-1987. Dosja i përket ish Fondit Operativ.
17. Dosje hetimore – gjyqësore nr. 40, në ngarkim të G. H., përkatësisht me 70 (shtatëdhjetë) fletë dhe 28 (njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1981-1982. Dosja i përket Fondi Ish Dega e Punëve të Brendshme Durrës.
18. Dosje nr. 37, fashikull i përgjithshëm i bandës së diversantit T. T., me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1951-1953. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1951.
19. Dosje nr. 27, aktiviteti i Heroi të Popullit P. M., me 5 volume, në total 173 (njëqind e shtatëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1949-1950. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1951.
20. Dosja nr. 76, “Pasqyra statistikore mbi hyrjet e diversantëve jugosllavë e grekë gjatë vitit 1952-1953”, me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.
21. Dosja nr. 72, “Raporti vjetor mbi gjendjen dhe veprimtarinë e bandave, diversantëve, pasqyra mbi hyrjet dhe daljet e diversantëve, dështimet me bandat dhe pasqyra statistikore”, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1953. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.
22. Dosja nr. 84, “Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës diversante të D. P. nga Kukësi”, me 24 (njëzetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1952-1954. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.

23. Dosja nr. 83, “Fashikull i përgjithshëm informatash për bandën e diversantit G. D. Shkodër”, me 42 (dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1953-1959. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.
24. Dosja nr. 70, “Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës së S. K. nga Fieri”, me 84 (tetëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1945-1952. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.
25. Dosja nr. 87, “Fashikull i kërkimit për bandën diversante të S. S. nga rrethi i Shkodrës”, me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1952-1953. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 195.
26. Dosja nr. 86, “Fashikull i materialeve për kërkimin e bandës diversante të Q. Xh. nga rrethi i Tropojës”, me 30 (tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1949-1953. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.
27. Dosja nr. 85, “Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës diversante të A. N. nga rrethi i Kukësit”, me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1950-1953. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.
28. Dosja nr. 69, “Fashikull i përgjithshëm i banditit L. P. nga rrethi Shkodër”, me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1955-1955. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.
29. Dosja nr. 67, “Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës diversante të M. K. nga rrethi i Shkodrës”, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1952. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.
30. Dosja nr. 65, “Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës diversante të M. Z. nga rrethi i Fierit”, me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1952-1954. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.
31. Dosja nr. 60, “Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës diversante të K. Gj. nga rrethi i Kukësit”, me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1952-1957. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.
32. Dosja nr. 57, “Procesverbale hetimore mbi deponimet e të arratisurve V. V. dhe N. B., diversantë të kapur nga organet tona”, me 49 (dyzetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1952. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.
33. Dosja nr. 56, “Fashikull i përgjithshëm informatash i bandës së diversantit M. M. nga rrethi i Shkodrës”, me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1952-1953. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.

34. Dosja nr. 52, “Fashikull me dokumentet operative për diversantin Th. A. nga Tragjasi i Vlorës”, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1951-1953. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1952.
35. Dosja nr. 44, “Fashikull i dosjes të arratisurit Ll. K. nga Rrësheni”, me 42 (dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1951.
36. Dosja nr. 45, “Fashikull i përgjithshëm i bandës K. Z. nga rrethi i Korçës”, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1951-1952. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1951.
37. Dosja nr. 43, “Fashikull i përgjithësimit të grupit antikounst L. P., në Kukës”, me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1951-1957. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1951.
38. Dosja nr. 41 “Fashikull informatash i bandës P. Q. nga Puka”, me 24 (njëzet e ktër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1951-1955. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1951.
39. Dosja nr. 95 “Fashikull i bandës së diversantit R. B. nga Pogradeci”, me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1951-1954. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1954.
40. Dosja nr. 92 “Raporti vjetor si dhe raportet 3 mujore mbi veprimtarinë e bandave të armatosura, pasqyra statistikore mbi hyrjet e bandave dhe përpunimeve të agjenturës”, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1954. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1954.
41. Dosja nr. 91 “Fashikull i përgjithëm i informatave të bandës Xh. T. e shokë nga rrethi i Korçës”, me 31 (tridhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1953-1959. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1954.
42. Dosja nr. 96 “Relaion mbi punën që ka zhvilluar U.D.B. Jugsllave kundra punëtorëve operative të Sigurimit të Shtetit”, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1954. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1954.
43. Dosja nr. 97 “Relacion i bandës së diversantit C. D. nga Dukati Vlorë”, me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1954. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1954.
44. Dosja nr. 98 “Fashikull i kërkimit në drejtim të bandës diversante të A. T. nga rrethi i Skraparit”, me 242 (dyqind e dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1954.
45. Dosja nr. 99 “Raporti vjetor dhe tre mujor si dhe statistikat përkatëse mbi gjendjen e bandave dhe diversantëve e rezultatet e luftës kundër tyre gjatë vitit 1955”, me 242 (dyqind e dyzet e

- dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1950-1963. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1955.
46. Dosja nr. 88 “Fashikull i kërkimit për bandën e rrëzuar nga diversanti D. N. nga rrethi i Kukësit dhe e përbërë nga H. Xh., E. Ç., S. D., L. Ç., G. S. e R. H.”, me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1950-1957. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.
47. Dosja nr. 105 “Relaion mbi arratisjet janari deri në shtator dhe pasqyrat statitkore”, me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1950-1957. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1953.
48. Dosja nr. 106 “Fashikull i diversantit R. B. nga rrethi i Tropojës”, me 23 (njëzetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1956-1961. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1956.
49. Dosja nr. 107 “Fashikull të dhënash dhe plane e relacione për të arratisurin F. B., Vllah”, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1956-1957. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1956.
50. Dosja nr. 108 “Raporti vjetor dhe statistikat përkatëse mbi punën e kryer nga dega IX në drejtim të bandave dhe diversantëve”, me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1957. Dosja i përket Fondit nr. 4. Drejtoria e I-rë. Bandat. Viti 1957.

II. Deklasifikoi pjesësisht informacionin e mëposhtëm:

1. Fondi Ish Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, regjistër i agjenturës nr. 1, fleta, me rreshtin ku gjendet numri rendor 8937, në ngarkim të V. P. me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumenti daton në vitin 1961.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 1, datë 15.01.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me Vendimin nr. 4, datë 19.02.2021, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

Deklasifikimin e plotë të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” që gjendet në:

1. Kartelë Model 2, nr. 369, 23898, në ngarkim të I. A., me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
2. Kartelë Model 2, nr. 7225, në ngarkim të H. K., me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.
3. Evidenca agjentalo – operative nr. 300. Evidenca i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

VEPRIMTARI TË
AUTORITETIT PËR
INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E
ISH- SIGURIMIT TË
SHTETIT



VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHËTETIT PËR PERIUdhËN JANAR-SHKURT 2021

**Takim online njohës dhe prezantues me shoqërinë civile,
në kuadër të projektit: “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë
tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm.”**

Më 28 janar 2021, Zyra e Ballkanit Perëndimor të ICMP (Projekti në Shqipëri) me pjesëmarrjen e Zyrës Qendrore të ICMP në Hagë, Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe përfaqesues të Bashkimit Europian në Shqipëri organizuan online, takimin njohës dhe prezantues të përfituesve të granteve nga projekti i përbashkët ICMP-AIDSSH, “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm”, 2020-2021. Z. Simon Mirakaj, Anëtar, mban fjalën e hapjes për AIDSSH.



Shqipëria anëtarësohet në Rrjetin Europian të autoriteteve përgjegjëse për arkivat e ish-policive sekrete


Tiranë, 28 janar 2021– Në kuadër të takimeve vjetore të institucioneve të Rrjetit Europian të autoriteteve përgjegjëse për arkivat e ish-policive sekrete, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit mori pjesë në mbledhjen online të zhvilluar nga Instituti Çek për Studimin e Regjimeve Totalitare.

Takimet e Rrjetit, të organizuara me radhë nga vendet anëtare, me të ftuar edhe vëzhgues e të interesuar, bëjnë një paraqitje të punës së institucioneve përkatëse në vendet e tyre, duke shkëmbyer përvoja, përballur sfida, ndërmarrë nisma e projekte të përbashkëta, nxitur bashkëpunime e botime.

Aktivitetet vjetore të institucioneve të pranishme u prezantuan nga drejtuesit, të cilët në vijim miratuan rregullat procedurale të bashkëpunimit mes vendeve dhe institucioneve aplikuese, mes të cilave pranimin e Shqipërisë si anëtare dhe Ukrainës si vëzhguese.

Pranimi i Shqipërisë dhe AIDSSH-së si anëtar me të drejta të plota në Rrjet u bë me votë unanime të anëtarëve. Sipas përfaqësuesve të BSTU gjermane “Nuk mund të kishte kandidat më të mirë se Shqipëria, e cila po hap dosjet e komunizmit dhe po tregon historinë pas dokumenteve sekrete, duke bashkëpunuar me institucionet publike dhe vendore, akademikët, grupet e interesit, shoqatat e të drejtave të njeriut dhe përfituar nga përvoja e homologëve”.



Kjo është përgjegjësi e shtuar e AIDSSH për trajtimin e së shkuarës së afërt, dokumentacionit, punës hulumtuese, edukuese dhe ndërpruese me të rinjtë.



AIDSSH dhe ICMP, workshop online mbi menaxhimin e të dhënave mbi të zhdukurit

Më 3 shkurt, 2021, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi workshop online mbi menaxhimin e të dhënave mbi të zhdukurit, në bashkëpunim me Zyrën Rajonale për Ballkanin Perëndimor të ICMP-së.

Adnan Rizvic, drejtor i menaxhimit të sistemit të të dhënave të ICMP dhe drejtues të ICMP-së ndanë përvojën mbi 20-vjeçare të punës me të zhdukurit në 50 vende të botës, organizimin e sistemit, centralizimin e të dhënave dhe proceset komplekse deri në identifikimin e të gjeturve dhe mbetjeve njerëzore.



AIDSSH dhe ICMP, workshop online mbi benefitet e përdorimit të radarëve për identifikimin e të zhdukurve

Më 10 shkurt 2021 u zhvillua workshopi online mbi benefitet e përdorimit të radarëve me penetrimit të thellë për identifikimin dhe gjetjen e të zhdukurve, bashkëpunim i AIDSSH me Zyrën Rajonale për Ballkanin Perëndimor të ICMP-së.



Takim prezantues i Ambasadorit të Prezencës të OSBE-së në Shqipëri me Kryetaren Sula

Më 1 shkurt, Ambasadori i OSBE, Vincenzo Del Monaco, u takua me znj. Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, një ndër institucionet partnere kryesore të Prezencës të OSBE-së në Shqipëri.

Prej shumë vitesh, Prezenca i ka mbështetur institucionet shqiptare në përpjekjet e tyre për trajtimin e së shkuarës komuniste dhe roli i Autoritetit në këtë drejtim është ndër më të spikaturit. Ambasadori Del Monaco e vlerësoi përkushtimin e znj. Sula në këtë fushë.



Aktualisht, Prezenca po kontribuon në forcimin e debatit demokratik dhe në fuqizimin e institucioneve, duke mbështetur kapacitetet kërkuese dhe diskutimet akademike për drejtësinë tranzicionale. Ajo ka

mbështetur krijimin e një programi Master për Drejtësinë Tranzicionale në Universitetin e Tiranës, si edhe ngritjen e Qendrës për Drejtësi dhe Transformim, në të njëjtin universitet.

Prezenca do ta ndihmojë Autoritetin në punën e tij, veçanërisht për rritjen e ndërgjegjësimit publik për çështje të së kaluarës, si edhe për çështjen e personave të zhdukur të ekzekutuar gjatë regjimit komunist. Kjo do të bëhet përmes organizimit të platformave të diskutimit për sfidat që ka hasur institucioni dhe planet e tij për të ardhmen, si edhe përmes përkrahjes së kërkimeve akademike në këtë fushë.

Del Monaco tha se Prezenca do të vijojë ta mbështetë punën e Autoritetit dhe përpjekjet e të gjitha institucioneve shqiptare në fushën e drejtësisë tranzicionale dhe trajtimit të së kaluarës.

AIDSSH në aktivitete të zhvilluara në kuadër të muajit të kujtesës

17 Shkurt 2021, përfaqësues të AIDSSH morën pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit mbi “Librin e burgut”, dhe tematika të trajtuara në kuadër të muajit të kujtesës.



AIDSSH dhe Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, hapat e parë bashkëpunues

Më 19 shkurt 2021, në prag të 20 shkurtit, 30 vjet pas rrëzimit të shtatores së diktatorit Enver Hoxha, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit hapi dyert e tij për AIDSSH-në dhe propozimet konkrete për bashkëpunim.

Drejtuësja e AQSHF, znj. Iris Elezi bëri një paraqitje të kujdesshme e të detajuar të materialeve të tipologjive të ndryshme që ruhen në arkivin e tyre, duke evidentuar njëkohësisht elementët dhe fushat ku mund të punohet e studiohet bashkërisht.

Sipas znj. Elezi, “është e rëndësishme që e shkuara të trajtohet në mënyrë multidisiplinore dhe ka ardhur koha që kinematografia dhe të gjitha proceset e lidhura me të gjatë viteve të regjimit komunist, të shihen me transparencë. Kjo njohje e ndihmon të tashmen e të ardhmen, edhe të kinemasë shqiptare”.

“Jo pak ngjarje historike dhe personalitete janë trajtuar të deformuar në filmat shqiptarë të regjimit, duke prekur e cenuar dinjitetin njerëzor të të nëpërkëmburve e përçmuarve për të gjithë jetën e jo në pak raste, në disa breza. Hapja e dokumenteve të Sigurimit dhe njohja me “provat” e fabrikuara që dënuan sabotatorë, apo linçuan “armiqtë e popullit” është një mundësi për t’iu rikthyer në një optikë të re filmave, dokumentarëve, skenarëve, mjeteve të propagandës të përdorura dhe shfrytëzuara nga ish-Kinostudio “Shqipëria e re”, me qëllim indoktrinimin”, u shpreh kryetarja Sula.



Z. Simon Mirakaj, anëtar i AIDSSH, theksoi nevojën për një strategji kombëtare për kujtesën, e cila të përfshijë edhe mënyrën sesi kinematografia dhe letërsia u përdorën nga regjimi komunist për qëllime të propagandës dhe indoktrinimit politik.

Dy materiale filmike ilustruese të bashkëpunimit u shfaqën në sallën e AQSHF, të pasuara nga një vizitë në mjediset e institucionit, arkiv, kartotekë, bibliotekë, për njohje me proceset e punës. AIDSSH dhuroi botimet e veta për bibliotekën e AQSHF.



Personalitetet e para dhe ngjarjet historike, me pasojat përkatëse, që synohet të trajtohen në dritën e dokumenteve arkivore të dyanshme dhe materialeve jo vetëm në administrim të AIDSSH dhe AQSHF, janë të dënuarit e Kënetës së Maliqit, të dënuar publikisht dhe të ekzekutuar, të “ritreguar”

në filmin “Vitet e para”, si dhe Sejfi Protopapa, personazh i redikulizuar me Sali Protopapën dhe ballistët që denden me pula tek “I teti në bronz”, ndërsa AQSHF do të hulumtojë dosjet e ish-Kinostudios të ruajtura në AIDSSH.

OSBE, takim online për të shkuarën dhe të ardhmen me aktorët e kujtesës

Më 22 shkurt 2021, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri organizoi takimin online në kuadër të projektit “Lustracioni në Shqipëri: E shkuara dhe e ardhmja / Lustration in Albania: The past and the future”, ku AIDSSH u përfaqësua nga kryetarja, znj. Gentiana Sula.



Dëshmi për të zhdukurit në komunizëm, në një dokumentar të dedikuar

Dokumentari “Të zhdukurit” bazohet në dëshmi të të mbijetuarve, mes të cilave ajo e Ajet Hysës, për vendkëzimet dhe vendvarrimet në Mënik të Pezës, Tiranë.

Dëshmia u regjistrua nga gazetarja Luljeta Progni, në këtë bashkëpunim të kujto.al dhe AIDSSH.



AIDSSH përkujton të pushkatuarit e 26 shkurtit

Pas drekës së 19 shkurtit 1951 u hodh një sasi e vogël dinamiti në oborrin e ndërtesës së ambasadës sovjetike. Pati alarm në Ministrinë e Brendshme dhe qarqet e larta politike të Tiranës. Byroja Politike e KQ të PPSH u mbledh urgjentisht për të marrë në shqyrtim incidentin në ambasadë.

Ministri i Brendshëm, Mehmet Shehu, kërkoi nga Byroja Politike që arrestimet të bëheshin qysh atë natë, disa qindra persona, pa bërë hetime për ngjarjen dhe pa gjetur provat për personat e pandehur. Ministria e Brendshme dhe Sigurimi i Shtetit përpiluan listën e vdekjes, arrestimin dhe pushkatimin e 22 vetave (nga datat 19-26 shkurt 1951).

Secili prej emrave të përzgjedhur, të arrestuar me ngut dhe të dënuar politikisht, kishte një histori të pasur individuale dhe familjare, në fusha të ndryshme dhe përfaqësonte më së miri shtresën intelektuale e propperëndimore të Shqipërisë së asaj kohe.

Të arrestuarit u pushkatuan pas pesë ditëve, mesnatën e 26 shkurtit të vitit 1951, pranë Urës së Beshirit. Ky veprim u quajt i përligjur, sipas një dekreti me gjashtë nene, për „veprimtaritë terroriste” që u hartua me vonesë nga kreu i Ministrisë së Brendshme Mehmet Shehu dhe u miratua rrufeshëm nga Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe Byroja e PPSH, më 26 shkurt 1951, kur gjithçka, pa gjyq, kish marrë fund. Ministri i Drejtësisë nuk mori pjesë në këtë farsë.

Pas ekzekutimit të viktimave që shkuan drejt vdekjes pa e ditur pse, dokumentet gjyqësore u plotësuan me mangësi. Kur viktimat nuk jetonin më, nga një dokument i vonuar gjyqësor, u mor vesh se më datën 27 shkurt 1951, një trupë gjyqtarësh kishte dhënë vendim për dënimin me vdekje të 22 të vdekurve.

Familjet e të ekzekutuarve u përdoqën brutalisht për vite me radhë. Në korrik të vitit 1991 ata kërkuan pafajësinë e familjarëve të pushkatuar pa gjyq. Vendimi i Gjykatës së Lartë i shpalli të pafajshëm 22 intelektualët e dënuar.



Në vitin 1993, të sinjalizuar nga banorë të zonës dhe të orientuar nga dëshmitarë okularë, familjarët arritën të gjenin vendekzekutimin dhe vendvarrimin e përfolur pranë Urës së Beshirit. Me identifikimin e vendit u krye edhe zhvarrimi i tyre dhe më pas rivarrimi me të gjitha nderimet në varrezat e Dëshmorëve të Kombit.



Presidenti i Republikës ka nderuar me medalje 22 intelektualët e ekzekutuar, po ashtu familjarët e tyre për vlerat dhe dinjitetin njerëzor të treguar në vite.

Më 26 shkurt 2021 mbushen 70 vjet nga ekzekutimi i intelektualëve Sabiha Kasimati, Tefik Shehu, Pjetër Guraziu, Jonuz Kaceli, Anton Delhysa, Haki Kodra, Gafur Jegeni, Myftar Jegeni, Manush Peshkëpia, Reiz Selfo, Qemal Kasaruho, Zyhdi Herri, Gjon Temali, Petro Konomi, Niko Lezo, Pandeli Nova, Thoma Katundi, Mehmet Shkupi, Ali Qorralliu, Fadil Dizdari, Hekuran Troka, Lluca Rashkoviç.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre!

NJOHJA NXIT STUDIMIN

Studimet e mëposhtme u përgatitën në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH me ASA, ISKPK, IIPP “*Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri, 1944-1990*”



Pohimi nga Byroja Politike e PPSH i dhunës ndaj të burgosurve dhe internuarve nga organet e Sigurimit të Shtetit deri në vitin 1953

Dr. Gjon Boriçi

Kumtesa përqendrohet në vitin 1953: Diskutimet e Byrosë Politike dhe të MP të Brendshme për “gabimet” e Sigurimit të Shtetit ndaj të burgosurve dhe internuarve, përgjegjësia e ministrit të brendshëm, Mehmet Shehu, dhe shpërblimi i tij duke e promovuar në detyrë. Dokumentet zyrtare

pohojnë sjelljen terroriste të shtetit kundrejt një pjese të madhe të popullit, të cilin e vrau, burgosi, torturoi, dëboi, internoi pa asnjë ligj.

Dhuna shtetërore e Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH) nuk përqendrohej vetëm tek arrestimi dhe dënimet me gjyqe farsë të elementëve kundërshtarë, por edhe tek pushkatimet pa gjyq. Një nga metodat e këtyre pushkatimeve ishte rrëmbimi i njerëzve nga banesat në mes të natës dhe më pas për fatin e tyre nuk dihej më asgjë, deri sa vinte ndonjë njoftim i organeve të Sigurimit.

Jeta në kampet e punës së detyruar, nga vështrimi i raporteve zyrtare

Dr. Femi Sufaj dhe Marinela Sota

Situata politike dhe ekonomike e vendit, në të cilën u ngritën kampet e punës së detyruar, lidhet me instalimin e regjimit komunist dhe nivelin tepër të ulët të ekonomisë dhe infrastrukturës. Puna e detyruar e të dënuarve, të paraburgosurve, të internuarve, të dëbuarve, të moshuarve, të rriturve, fëmijëve, burrave dhe grave, i ka lënë gjurmët e saj në të gjithë vendin nga veriu në jug, në fusha, rrugë, miniera dhe qytete, duke mbajtur një peshë të rëndësishme në të ardhurat e shtetit të periudhës së regjimit komunist.

Nëpërmjet studimit do të paraqiten të dhëna të shumta mbi përmasat e përndjekjes gjatë regjimit komunist dhe njëherazi, analiza të aspekteve të rëndësishme si, përbërja sociale e të dënuarve politikë gjatë regjimit komunist, diferencimi dhe veçimi politik i grupeve të caktuara të shoqërisë, pasojat e politizimit dhe ideologjizimit të sistemit të drejtësisë penale.

Tipologjia e dokumenteve të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit 1944-1991

Dr. Ardiana Topi

Ky studim ka për qëllim të analizojë mënyrën e krijimit të dokumenteve arkivore të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit në institucionet qendrore të tij, ashtu edhe në strukturat lokale, apo siç njihen ndryshe me emrin degët e punëve të brendshme në rrethe e organet e Sigurimit në ushtri.

Gjithashtu, pjesë e studimit është edhe përshkrimi i fondeve arkivore që ruhen në arkivin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, arkivin e AIDSSH-së. Fondet arkivore përfshijnë fondin e zbulimit, kundërzbulimit, rrjetit sekret të informatorëve, fondin e hetuesisë, etj.

Kategoritë e dosjeve të dokumenteve, pjesë e këtyre koleksioneve janë të larmishme. Ato përfshijnë dosje me dokumente administrative dhe korrespondencën zyrtare, dosje të personave që viheshin në përpunim në nivele të ndryshme, dosje të bashkëpunëtorëve, dosje të hetuesisë dhe proceseve gjyqësore, etj...

**Trajtimi i shtetasve italianë në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore, nga prof.
Venanzio Lozzi tek Atë Giacomo Gardin**

Prof. Dr. Nevila Nika

Mbarimi i Luftës II Botërore shënon për shtetasit italianë të mbetur në Shqipëri nisjen e një periudhe disavjeçare përpjekjesh për riatdhesim e njëkohësisht, përndjekjesh (ekzekutime, burgime, vdekje në kampe e burgje, kampe pune të detyruar), apo zhdukje pa asnjë gjurmë nga ana e pushtetit të ri të vendosur në Shqipëri.

Janë shfrytëzuar dokumentet autentike nga Arkivi Qendror i Shtetit, Arkivi i Ministrisë së Jashtme, Arkivi i Ministrisë së Brendshme. Sipas mjaft burimeve, llogaritet që në Shqipëri të kenë mbetur rreth 27.000 qytetarë italianë, përfshirë këtu edhe ushtarakë të të gjitha rangjeve dhe civilë të ardhur para e, sidomos, pas 7 prillit 1939. Gjendja e krijuar në Shqipëri mbas kësaj date gjithashtu paraqitej mjaft konfuze pasi, pothuaj menjëherë, në territorin shqiptar nuk vonuan të hynin trupat gjermane...

Robërit gjermanë të luftës dhe puna e detyruar gjatë viteve 1944-1952

Dr. Marenglen Kasmi

Historia e robërve gjermanë të Luftës së Dytë Botërore shtrihet në një hapësirë kohore prej më se 17 vitesh, qysh prej fillimit të luftës në shtator 1939, e deri në fillim të vitit 1956, kur u riatdhesuan edhe ushtarët e fundit gjermanë nga kampet sovjetike.

Statusi ligjor i të burgosurve të luftës u përcaktua në Konventën e Hagës të vitit 1907 “Mbi ligjet dhe zakonet e luftës” dhe në Konventat e Gjenevës të vitit 1929 “Për lehtësimin e fateve të të plagosurve dhe të sëmurëve në luftën ndërmjet ushtrive” si dhe “Për trajtimin e të burgosurve të luftës”.

Edhe në Shqipëri, ashtu si në çdo vend tjetër ku shkeli këmba e ushtarit gjerman dhe u luftua ndaj pushtuesit, u kapën robër gjermanë, të cilët u përqendruan në kampe robërisht, më saktë kampe pune të detyruar. Nëse në vendet e tjera është shkruar shumë për këtë fenomen, në Shqipëri ende nuk është bërë ndonjë studim shterues për robërit gjermanë të luftës dhe fatet e tyre. Duke bërë një krahasim të burimeve gjermane dhe materialeve arkivore shqiptare, në këtë artikull do të mundohem të hedh sadopak dritë mbi këtë pjesëz të pandriçuar të historisë sonë...

**Shkodra në vitet e vendosjes së diktaturës, 1945-1953, nga këndvështrimi
i Historikut të Sigurimit të Shtetit**

Selami Zalli

Pa hyrë në rolin historik të Shkodrës si kryeqendër politike, ekonomike e kulturore ndër shekuj, do të përpiqem që nëpërmjet këtij studimi të qëndroj brenda temës që përcakton kjo konferencë

shkencore: “Shkodra në vitet e vendosjes së diktaturës, 1945-1953, nga këndvështrimi i Historikut të Sigurimit të Shtetit”, duke u përqendruar në disa probleme kryesore.

Me hyrjen në fuqi të ligjit 45/2015 dhe fillimin e aktivitetit nga AIDSSH-ja, me marrjen në dorëzim të arkivit ekzistues, i përbërë nga një fond i konsiderueshëm dokumentesh, dokument me rëndësi për studimin e kësaj periudhe, pjesë përbërëse e këtij fondi është dhe “Historia e Sigurimit të Shtetit” dhe “Historiku i Degës së Punëve të Brendshme Shkodër”, të zgjedhur si materiale kryesore referues për bërjen e një analize mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të kësaj strukture, pa paragjykime dhe reminishenca në vështrimin ligjor, analitik e krahasues, duke vënë në dukje dhe zhveshur nga hiperbolizimet (megalomania), pa synuar injorimin dhe denigrimin e saj, por vetëm nëpërmjet vështrimit në optikën e kohës, në plan krahasues.

Internim-dëbimet familjare në zonën e Dumresë 1968-1991: dëshmi dhe refleksione

Alma Liço Mirakaj dhe Prof. As. Dr. Merita Sauku Bruci

Dëshmi direkte mbi periudhën e internim-dëbimit dhe mbi kohën, shkakun, mënyrën se si u kryen, pasojat që tjetërsuan jetët e familjarëve të referueses dhe jo vetëm. Dëbimi nga qyteti i Tiranës u krye në vitin 1968, tok me 15-20 familje të tjera që u vendosën në zonën e Dumresë, në fshatin më të largët, Dragot, ku u trajtuan si armiq të partisë dhe të popullit.

Shkaku i dëbimit: aktiviteti i gjyshit, Muamer Liço, që kishte studiuar për drejtësi në Universitetin e Harvardit, ishte avokat në qytetin e Korçës dhe si nacionalist, u përfshi në lëvizjen e Ballit Kombëtar. Persekutimi komunist viktimizoi katër breza në familjen e saj: gjyshi, i dënuar në vitin 1945 me pushkatim, dy prindërit me tre fëmijët për 23 vjet në internim - dëbim; si dhe fëmijët e vetë Almës, që u lindën dhe kaluan vitet e para të fëmijërisë në fshatin e dënimit...

Qyteti minator i Selenicës në Vlorë

Natasha Llanaj Përpunja

Merret në analizë qyteti i vogël minator i Selenicës në Vlorë, i kthyer në vend internimi dhe izolimi për shumë kundërshtarë të regjimit.

Ashpërsimit të luftës së klasave, humbjeve të jetës së minatorëve në galeritë e minierës, iu shtua dhe frika se kush e kishte radhën të merrej i detyruar apo kush po sillej me Gazin 69, i frikshëm jo vetëm te familjet direkt të goditura, por për gjithë qytetarët dhe më gjerë, për të gjithë lokalitetin me rrethinat, Lubonjë, Picar, etj.

Modestisht dua të shpreh mendimin dhe qëndrimin tim të kahershëm dhe të sotshëm në raport me diktaturën komuniste të Shqipërisë sonë dhe falënderoj organizatorët që besuan tek unë dhe më dhanë mundësinë të shprehem. Nuk vij si historiane, por vij si studiuese, si qytetare bashkëjetuese në një vend të izoluar, ose siç quhej, vend internimi.

Vështrim krahasues mbi rehabilitimin e viktimave të komunizmit, rasti çek, gjerman, polak, estonez dhe rumun

Erald Kapri

Shqipëria përfaqëson një eksperiencë unike në lidhje me çështjen e rehabilitimit të viktimave të ish-sistemit diktatorial komunist. Prej vitit 1991, ka një legjislacion të gjerë për këtë shtresë të popullsisë, i cili ende në pjesën më të madhe të tij është i pazbatuar. Mbi 25 vjet nga rënia e regjimit komunist, Shqipëria nuk ia ka dalë dot të kryejë një rehabilitim të qenësishëm ndaj shtetasve që vuajtën në diktaturë. Të dhënat e fundit nga Ministria e Financave flasin për një faturë financiare prej 750 milionë dollarësh, nga të cilat janë shlyer 230 milionë dollarë, ku 178 milionë përmes kësteve dhe pjesa tjetër përmes letrave me vlerë dhe apartamente për strehim.

Ky punim nuk ka për qëllim të vendosë në pah marginalizimin në histori dhe gabimet e së kaluarës, por ka si synim të përcjellë eksperiencat e vendeve që po kalojnë vështirësi të ngjashme, si një mënyrë për të mësuar sistemin ligjor, edukimin dhe kujtesën e shoqërisë dhe nevojën për të vlerësuar viktimën dhe dënuar fajtorët.

Ky vështrim krahasues për vendet evropiane me të kaluar komuniste si Gjermania, Çekia, Polonia, Estonia dhe Rumania mund ndihmojë në përfundimin e përvojës së tyre për t'u aplikuar më pas në Shqipëri për të përmirësuar sadopak gabimet e tranzicionit...

Shfrytëzimi i krahut të punës në repartet e xhenios dhe ndërmarrjet ushtarake bujqësore: trajtimi diskriminues i ushtarëve që vinin nga familjet e deklasuara

Etleva Smaçi

Diskutimi analizon shtrirjen e luftës së klasave edhe në shërbimin e detyrueshëm ushtarak, mungesën e besimit të fëmijët e “armiqve të klasës” për t'i pajisur me armatimin ushtarak, paracaktimi i tyre për shërbim të detyrueshëm në repartet e xhenios e pas viteve '70, me krijimin e Ndërmarrjeve Bujqësore Ushtarake, edhe në to.

Të gjithë dëshmitarët okularë, ushtarakë pjesëtarë të forcave të xhenios, në intervista apo edhe në botime në formën e kujtimeve, pohojnë se “forcat e xhenios, përveç mbrojtjes së shtetit në rast lufte, punuan edhe për ndërtimin e objekteve social-ekonomike”. Por ajo që shpesh mungon në këto dëshmi që kryesisht vijnë nga ushtarakët që kanë qenë drejtues të batalioneve, brigadave apo Divizionit të Xhenios, është fakti se këto reparte shfrytëzuan për ndërtimin e veprave të mëdha, krahun e lirë të punës së ushtarëve, si dhe faktin se përzgjedhja e tyre për repartet e xhenios bëhej mbi kriteret klasore...

Dëbimet e komunizmit dhe puna e detyruar: përvoja polake, historia dhe kujtesa

Lukas Kaminski

Dëbimet masive dhe puna e detyruar kanë qenë pjesë e komunizmit që prej fillimit të tij. Aktet e para që e përcaktonin punën e detyruar si masë penale u miratuan në fillim të vitit 1918.

Në të njëjtën kohë u krijuan kampet e para sovjetike të përqendrimit dhe kampet e punës së detyruar. Gjatë luftës civile, kozakët dhe fshatarët u dëbuan masivisht nga zonat ku u realizuan kryengritjet.

Sistemi i kampit u zgjerua në periudhën e kolektivizimit intensiv të bujqësisë dhe zgjerimit industrial në fillim të viteve 1930. Ai u shërbeu dy objektivave: ndëshkimit dhe shfarosjes së armiqve aktualë dhe imagjinar të popullit, nga njëra anë, dhe shfrytëzimit të krahut të punës pa pagesë, nga ana tjetër.

Viktimat e kësaj politike përfshinin edhe polakët nga territoret e mëparshme polake të përfshira në Bashkimin Sovjetik. Në vitin 1936, rreth 40,000-50,000 polakë të konsideruar si kulakë, u dëbuan nga Ukraina Sovjetike në Kazakistan. 111.091 polakë u ekzekutuan, ndërsa 28.744 vetë u dënuan me qëndrime të gjata në kampet e Gulagut, ku iu nënshtruan një pune shkatërruese). Kjo përvojë së shpejti do të përfjetohej nga shumë polakë të tjerë...

Studimet mund t'i gjeni të plota në: https://issuu.com/aidssh/docs/te_mohuar nga_regjimi-1

PROFILE DHE RRËFIME



HALIT SELFO

Mes dhjetëra gjuhëtarëve dhe përkthyesve që së shpejti do të trajtohen në një projekt të zgjeruar të AIDSSH, sot sjellim në vëmendje përkthyesin e “Kontit të Monte Kristos” të Dymasë, “Djemve të rrugës Pal” të Molnarit, “Zemrës” së De Amicis, “Udhëtimeve të Guliverit” të Suiftit, “Robinson Kruzosë” të Defosë, “Rreth botës për 80 ditë” dhe “Bijtë e kapitenit Grant” të Zhyl Vernit, “Poemës Pedagogjike” të Makarenkos e më shumë se 50 veprave letrare, mjeshtër të gjuhës Halit Selfo.

Halit Xhevdet Selfo lindi në maj të 1918 në një familje tregtare me tradita në Gjirokastrë.



Mësimet e para i mori në vendlindje, ndoqi Liceun Francez të Korçës dhe studimet e larta i kreu në Padova të Italisë. U arrestua në vitin 1946 dhe u dënua për agjitacion e propagandë, dënim që e kreu në kampin e Maliqit, krah shumë intelektualëve të tjerë, si Dhimitër Pasko, Arshi Pipa, Vexhi Buharaja... U lirua në 1949. Iu kushtua përkthimeve nga frëngjishtja, anglishtja, rusishtja dhe italishtja, duke ngritur ura komunikimi të shqiptarëve brenda kufijve me Europën, Perëndimin e botën mbarë deri ditën që mbylli sytë, 14 tetor 1964.

** Dosja e Halit Selfos dhe grupit me të cilin u dënua mund të vihet në dispozicion të të interesuarve, sipas ligjit 45/2015 i ndryshuar.*

AKILE TASI



Akilenë, pas Maliqit e çuan në Burrel, në atë repart shpirttrash në venitje që fikeshin në gjysmerrësirë. Vdiq aty nga ceroza mbas 17 vjetësh burgim, në janar të vitit 1961, duke lënë kujtimet më të mira të të burgosurit, gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar këdo që donte të mësonte anglishten.

Në kohën që u sëmur, babai i Lekës nuk ndodhej në Burrel, sepse e kishin sjellë në Tiranë për ta operuar. Sapo vëllai u nis drejt Tiranës, Akile u përkeqësua. Kur Koço Tasi u kthye në Burrel, e gjeti të vëllanë të varrosur. Familja i kishte çuar ilaçe, por nuk arriti ta shihte edhe një herë të gjallë.

Nga drejtoria e burgut u shkoi një telegram, ku njoftoheshin se njeriu i tyre kishte vdekur. Lekë Tasi thotë se shkoi të shihte vendin ku e kishin vënë, por nuk ia treguan.

“Kështu u shtua edhe një varr pa emër në një oborr të mënjanuar brenda telave. Kemi marrë vesh vetëm që ditët e fundit, shërbimin Akilesë ia bënë dy djem që vuanin dënime të gjata, Agim Llanaj dhe Tomorr Dosti”, rrëfen Lekë Tasi në kujtimet e tij.

* *Informacioni i mësipërm është përfshirë në ekspozitën “E shkuara e pakryer; të zhdukur në diktaturë”, bashkëpunim i AIDSSH me ICMP, IIPP dhe gazetaren Fatmira Nikolli, mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer Tiranë.*



LULE NË AJRI DAJLAN ZAIMAJ

Kur 12 dhjetorin e 1944-s në portën e Zaimëve u dëgjuan trokitje, askush nuk e dinte sekondat në vijim, do ta shndërronin jetën e tyre. Të zotit të shtëpisë, i kishte ardhur thirrje nga Dega e Brendshme e Skraparit që të paraqitej në Degë. Para se të nisej, së shoqes, e tre fëmijëve u tha “mos kini merak” dhe iku. I biri Gramozi ishte 9 vjeç dhe ishte fëmija i madh, pas vetes kishte tri motra. Ishte hera e fundit që e panë të atin, ai, nuk u kthye më kurrë.

Akuzohej si pjesë e forcave të Ballit Kombëtar. Një vit më vonë u dënua me 101 vite burg. Me faljet e dy viteve më pas, dënimi iu ul në 25 vjet burg. Shteti i kohës i sekuestroi pasurinë familjes që mezi mbijetonte. Nga burgu, Dajlan Zaimaj u çonte letra të afërmve dhe u kërkonte të shkonin ta shihnin. “Ejani shihni të sëmurin”, kaq kujton i biri nga letrat e të atit.

Më 2 qershor 1949, pas 10 vitesh vetmie, vdiq në burg nga torturat, sëmundja dhe uria. I biri, Gramozi, thotë se e mban mend të anë si një mesoburrë, disi të mbushur, që mbante ngahera një kapelë me strehë. Nuk ka asnjë fotografi të tijën. Trupi nuk iu dorëzua familjes dhe nuk dihet ku është as sot.

“Më kanë thënë ‘nuk ka gjë këtu, po si gjithë të tjerët shko e hidh lule atje matanë se i kanë zënë pallatet varrezat. Atje e kanë rrafshuar kanë bërë varreza, pallate, fushë sporti”- thotë Gramozi.

Ish-të dënuar në Burrel thonë se të vdekurit i varrosnin në të njëjtin vend, “përballë dritareve të qelive mes dy rrethimeve, në mënyrë që të gjithë ta shihnin se ç’fund do të pësonin. Kufomat, cullake - rrobat dhe gjërat e tjera i ndanin mesvedi xhelatët - të mbështjellë me batanije i varrosnin në radhë, njërin ndanë tjetrit, pa emër dhe pa asnjë nishan”.

* Profili i mësipërm është zbuluar në filmin “Të zhdukurit, të gazetares Luljeta Progni.

* Po ashtu, është përfshirë në ekspozitën “E shkuara e pakryer; të zhdukur në diktaturë”, bashkëpunim i AIDSSH me ICMF, IIPP dhe gazetaren Fatmira Nikolli, mbështetur nga



FËMIJËT E PARRITUR LEK PERVIZI

Ndonëse nuk ka dokumente zyrtare, sipas përllogaritjes së ish-të dënuarve politikë, në Kampin e Tepelenës mendohet se kanë vdekur rreth 300 fëmijë të internuar.

“Vetëm në një natë kanë vdekur 33 foshnja. Një prej tyre shpëtoi. Nisën ta thërrisnin “Beba”, dhe sot ka akoma ende këtë emër”, – thotë Lek Pervizi, një piktor 90-vjeçar, që kujton çdo gjë që ka përjetuar në Tepelenë. Beba është bashkëshortja e tij dhe janë rritur bashkë nëpër kampe. Si dëshmitar, ai ka vizatuar që në vitet 1950 sिका se si ishte kampi, 600 veta në një kazermë, 4500 në gjithë kampin. Skicat e tij mbeten ende sot pamjet e vetme që dëshmojnë si funksiononin 5 kapononet si kamp. Njëherësh, përmes skicave të tij, ai ka shenjuar edhe dukuritë e ngjarjet e rënda që kanë ndodhur në Tepelenë, si vdekja e fëmijëve.

“Kishte ngrica. Nënëat na lanin jashtë. Në mbrëmje, binim për të fjetur, por në mëngjes jo të gjithë fëmijët zgjoheshin. Kishin ngrirë në gjumë” kujton Simon Mirakaj, një tjetër i shpëtuar nga Tepelena.



Ish-të internuarit e kanë cilësuar kamp shfarosjeje, për shkak të numrit të madh të të miturve që humbën jetën prej mungesës së ushqimit, kequshqyerjes, higjienës, ujit që konsumonin dhe mungesës së kujdesit shëndetësor.

Kampi që kishte funksionuar gjatë luftës si kazermë ushtarake e italianëve, nuk ishte çminuar para vendosjes së të internuarve politikë. Disa fëmijë e humbën jetën duke luajtur me mina në oborrin mes kapanoneve, jashtë vëmendjes së të rriturve. Hamit Balaj nga Tropoja rrëfen se aty, një prej fëmijëve të ndarë nga jeta, ka qenë daja i tij. “Prindërit e nënës

ishin arratisur duke menduar të përgatishnin kushtet dhe të ktheheshin për të marrë tre fëmijët. Por një ditë pas arratisjes, fëmijët i internuan në Tepelenë. Nëna ime, Mine Mulosmanaj, 13 vjeçe, kishte ardhur në kamp, me të motrën 11 vjeçe dhe vëllanë e vogël 9 vjeç. Një ditë kanë qenë të gjithë jashtë. Nëna dëgjoji zhurmë mine. Trupi i një fëmije shpërtheu në ajër. Prej tij mbeti vetëm një çorape. Çorapja ishte e të vëllait, Shemsedin Çelë Mulosmanaj. Ai po luante me mina dhe njëra i kishte shpërthyer në duar. “

"Vllau ishte amaneti im. Isha ba nanë për të. Qysh se shkum në kamp, isha mundu me e ngop së paku me bukë. Atë ditë i dhashë me hanger, të paktën. Më duket se u ngop, se ma dha mue një copë bukë. Kjo më qetëson disi. Nuk iku i untë. Pashë një shpërthim e dëgjoja një zhurmë. Kur u afrova, kishte mbet' vetëm një çorap i tij. Nuk e deshta ma veten. Kam qa e bërtit, kam vu kujën. Si e humba vëllanë para syve.... Mora një çarçaf e mblodha copat e trupit të tij. Aq sa munda... Nuk kisha si me i ba arkivol vëllait tem të vogël. Mblodha pak drresa e i ngula në tokë, që me mujt me vu trupin e tij në të. E mbulova me dhe, si mujta e si dita. Prej asaj dite kam rujt vetëm çorapin e tij. As vetë nuk e di si e kam rujt. Çorapja e vëllait, vetëm kjo mbeti prej tij. Pengu e dhembja për të", tha në një bisedë për këtë ekspozitë Mine Mulosmani.

Ajo ka dorëzuar kampionin e ADN-së në ICMP, për të kërkuar eshtrat e tij.

Të mbijetuarit thonë se fëmijët e pleqtë që vdisnin varroseshin jashtë kampit, por vendet e varrimit kanë ndërruar tri herë. Rripat e tokës ku preheshin të vegjlit ishin në kohë të ndryshme, te ura e Bënçës, buzë lumit, e nëpër shpate të pjerrëta. Gjatë dimrit, lumi që vërshonte i merrte, duke u marrë prindërve kujtimet e vetme që kishin me foshnjat që nuk u rritën kurrë. Skicat e Lekë Pervizit i dëshmojnë edhe varret e panumërta.

** Informacionet e mësipërme janë përfshirë në ekspozitën “E shkuara e pakryer; të zhdukur në diktaturë”, bashkëpunim i AIDSSH me ICMP, IIPP dhe gazetaren Fatmira Nikolli, mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer Tiranë.*

NJË VARR PËR TË GJITHË

Më 19 shkurt të vitit 1951, në orën 18.00 pranë Ambasadës së Bashkimit Sovjetik në Tiranë, shpërtheu një lëndë eksplozive. Ngjarja që njihet si bomba në Ambasadën Sovjetike, u përdor si

pretekst për ekzekutimin e kundërshtarëve të regjimit. Një javë më pas, mesnatën mes 25 dhe 26 shkurtit, 22 intelektualë të vendit, nxirren nga qelitë e burgut të lidhur në pranga dhe vihen në një kamion që ka marrë udhën për nga Ndroqi. Banorët e zonës kanë parë gjatë atyre ditëve të hapet një gropë e madhe në Mënik, afër Urës së Beshirit. Rreth orës 12:30- 1:00 të natës dëgjoen



breshëri armësh dhe britma. Britmat e një gruaje. (Thuhet të ketë qenë Sabiha Kasimati).

Atë natë, banorët nuk e dinin se jetët që fikeshin qenë pushkatime pa gjyq. Njëri prej tyre që u ndërrua me ushtarët orët e para të 26 shkurtit, u porositi të hapte fjalën se qenë ekzekutuar kuaj të lodhur. Të nesërmen, kryetari i këshillit të fshatit kaloi për të parë ç’kishte ndodhur dhe pa të shpërndara këpucë e rroba. Duke qenë se trupat e pajetë nuk ishin mbuluar mirë dhe pranë varrit të pamatë afroheshin qentë, ai njoftoi eprorët se çfarë po ndodhte. U porositi të heshte. Disa ditë më vonë, një ekskavator e rrafshoi vendin.

Pavarësisht porosive, banorët e zonës ishin të vetëdijshëm se breshëritë e shpeshta në errësirë,

britmat dhe lëvizjet e kamionëve netëve pranë urës, nënkuptonin jetë të humbura. Pronarët e truallit e kishin lënë me amanet që ajo tokë aty të mos përdorej kurrë për gjë tjetër, veçse për të mbjellë pemë. Ata e dinin që atje kishte varre të panumërta të pushkatuarish nga diktatura.

Eshtat e 22 intelektualëve që u ekzekutuan në shkurtin e vitit 1951, u gjetën nga ngulmimi i Hysen Shehut, djalit të njërit prej viktimave. Më 1993, ai mundi të mbledhë informacione të dëshmitarëve dhe banorëve të zonës, si familja e ish-kryetarit të këshillit të fshatit, Kadri Hysa. Me identifikimin e vendit, pas 6 muajsh gërmime, në 5-6 gropa, u has në një unazë që shenjoi lidhjen me të pushkatuarit për bombën në Ambasadën Sovjetike. Në qershorin e vitit 1993 u krye zhvarrimi i tyre dhe më pas rivarrimi në varrezat e Dëshmorëve të Kombit. Sot, në nderim të tyre, një rrugë mban emrin “26 shkurti”.

** Me propozim nga AIDSSH, Presidenti ka vlerësuar me titullin “Për Merita të Veçanta Civile” Kadri Hysën, Faslli Hysën, Gëzim Mullajin, Aleksandër Dhimën, Hysen Shehun dhe Osman Kacelin, si dëshmitarë dhe kontribues të zbulimit, gjetjes dhe vënies në vend të drejtësisë për 22 intelektualët e pushkatuar pa gjyq 68 vite më parë.*



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Adresa
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al